

VENDIM
Nr.754, datë 8.7.2009

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS, ME NDARJE PRODHIMI, PËR KËRKIMIN,
ZHVILLIMIN DHE PRODHIMIN E HIDROKARBUREVE, NË SHQIPËRI, NË TOKË,
NË BLOQE “2-3”, NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE
ENERGJETIKËS, PËRFAQËSUAR NGA AGJENCIA KOMBËTARE E BURIMEVE
NATYRORE (AKBN), DHE “DWN PETROLEUM AG”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 13 të ligjit nr.7746, datë 28.7.1993 “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e kontratës, me ndarje prodhimi, për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve, në Shqipëri, në tokë, në blloqet “2-3”, ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, përfaqësuar nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) dhe “DWM Petroleum AG”, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtre.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha